



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 47
Prishtinë, më 18.05.2010 në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N- 225

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Arsim Rexhepi, kryetar, Drita Kadriu, Enis Kervan, Haset Cakolli, Mark Krasniqi, Adem Hajdaraj dhe Dragan Dimiq.

Munguan Donika Kadaj –Bujupi dhe Memli Krasniqi.

Në mbledhje prezantuan: Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit Lutfi Haziri, përfaqësuesi i OSBE - së, NDI - së, përfaqësues nga mediat, përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit si dhe praktikantë të caktuar për Komisionin.

Nga sekretaria e Kuvendit mori pjesë Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu

Mbledhjen e udhëhoqi: Arsim Rexhepi kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 05.05.2010
3. Shqyrtimi i Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian në fushën e Kulturës
4. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 5.05.2010.

Procesverbali i mbledhjes së datës 05.05.2010 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian në fushën e Kulturës

Kryesuesi, përshëndeti ministrin dhe e ftoi të raportoi lidhur me të arriturat dhe progresin në drejtim të përmbushjes së Planit të Veprimit për Integritet Evropian për fushën e kulturës.

Ministri i kulturës Lutfi Haziri, prezantoi para anëtarëve të Komisionit Strategjinë për konservimin e Trashëgimisë Kulturore dhe Religjioze. Ai tha se për këtë aspekt Ministria ka iniciuar hartimin e Politikës për Konservimin e Integruar, dhe se dokumenti do të jetë i gatshëm deri në fund të këtij viti.

Ministria nga qershori i këtij viti do të inicion themelimin e grupit ndërmintor me ministrinë tjera që përfshijnë këtë çështje.

Grupi punues për hartimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit është në fazën përfundimtare të tij dhe dorëzimit në Kuvend.

Grupi punues për hartimin e Ligjit për Hoqjen e Madhe ka disa ngecje pasi që komuniteti serb nuk ka bashkëpunim.

Me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore ministria është e obliguar të hartojë edhe Listën me Objektet e Inventarizuara të Trashëgimisë Kulturore . Kjo listë është paraparë të përfundojë në tremujorin e tretë të këtij viti.

Rrëth asaj se a janë përfshirë në planin hapësinor vendndodhjet e trashëgimisë kulturore, kjo çështje do të definohet pasi të miratohet Lista e Objekteve të Trashëgimisë Kulturore.

Heset Cakolli, kërkon sqarim nga ministri se a do të realizohen gjatë këtij viti sfidat që janë evidente të Planit të Veprimit për Integritet Evropian në mënyrë që të njëjtat të mos përsëriten vitin e ardhshëm, duke pasur parasysh se për përmbushjen e tyre mund të ketë edhe pengesa.

Enis Kervan kërkoi që pjesa e Trashëgimisë Kulturore në Raportin e Progresit të mos përfshihet vetëm si e drejtë e detyrim i komuniteteve pakicë pasi që Trashëgimia Kulturore ka të bëjë me të gjitha komunitetet.

Lidhur me Këshillin e Kosovës për Trashëgiminë Kulturore i cili është emruar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2007, e njoftoi Komisionin se si anëtarë i këtij Këshilli ka ofruar dorëheqjen, dhe se si i tillë Këshilli nuk mund të funksionojë me tre anëtarë pasi që një pjesë e anëtarëve të emruar nuk marrin pjesë në këtë Këshill.

Më tej shtoi se lista me anëtarët e Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore duhet të plotësohet nga Ministria dhe e njëjta të procedohet në Kuvend për miratim.

Drita Kadriu tha se Trashëgimia Kulturore është njera ndër segmentet më të rëndësishme që kërkon një interesim të madh, në këtë kontest Komisioni bashkëpunon me Këshillin e Kosovës për Trashëgiminë Kulturore për Listën e Objekteve të Trashëgimisë Kulturore.

Ajo theksoi se Komisioni në bashkëpunim me Ministrinë, duhet të merret me emrimin e anëtarëve të këtij Këshilli.

Ajo kërkoi sqarim nga ministri se çka parashihet të bëhet me Kullën e Isa Boletinit a do të inventarizohet apo të shëndrohet në muze.

Adem Hajdaraj tha se Këshilli i Kosovës për Trashëgiminë Kulturore ka një rëndësi të veçantë, ndërsa deri më tani nuk është marrë me çështjet e trashëgimisë.

Ai kërkoi sqarim nga ministri lidhur me vendndodhjen dhe statutin e Objekteve të Trashëgimisë Kulturore të Urës së Gurit në Vushtrri.

Kryesuesi, kërkoi nga ministri sqarim lidhur me ndërtimet që janë duke u zhvilluar rreth hapsirës së Urës së Gurit në Vushtrri.

Mark Krasniqi tha se në Listën e Objekteve të Trashëgimisë Kulturore janë përfshi më tepër objekte serbe se sa që në realitet janë, ai shtoi se shumica e kishave datojnë nga koha bizantine dhe se të njëjtat janë ruajtur një kohë të gjatë nga vetë shqiptarët. Ai tha se këto kisha për të cilat serbët pretendojnë se janë të tyre i takojnë shqiptarëve dhe kërkoi që të shiqohet historia e tyre më mënyrë që të mos politizohen objektet fetare.

Ministri në vazhdim tha se me qëllim të përmbushjes së detyrave që dalin nga Plani i Veprimit për ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore ka ndërmarrë një varg reformash, për këtë qëllim është themeluar edhe Inspektorati i Trashëgimisë Kulturore i cili do të merret me inventarizimin e objekteve dhe vlerësimet e tyre.

Sa i përket anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore ministri tha se është në kontakt me kryetaren e Këshillit për konsolidimin e tij dhe së shpejti pritet të plotësohet Lista e këtij Këshilli..

Sa i përket Kullës së Isa Boletinit, kjo çështje do të zgjedhet edhe me Institucionet tjera si dhe me Kuvendin Komunal.

Lidhur me statutin e Urës së Gurit në Vushtrri, ministri tha se kjo Urë është në Listën e Objekteve të Trashëgimisë Kulturore të mbrojtur.

Kryesuesi, kërkoi nga ministri sqarim lidhur me procedimin e projektligjeve të cilat i mbulon fusha e kulturës për këtë vit.

Ministri lidhur me këtë tha se projektligji për Sponzorimet në Kulturë është dërguar në Qeveri, ndërsa projektligjet tjera si ai për Muzeun dhe Teatrin pritet të finalizohen dhe së shpejti do të dërgohen në Qeveri.

4. Të ndryshme

Enis Kervan, tha se lidhur me çështjen e funksionimit të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore, Komisioni duhet të kërkon informatë me shkrim lidhur me anëtarët të cilët aktualisht punojnë në këtë Këshill.

Drita Kadriu ngriti çështjen e funksionimit të Këshillit Kombëtar të Shkencës dhe zhvillimet lidhur me Programin Kombëtar të Shkencës.

Komisioni mori qëndrim që të kërkoj nga informatë me shkrim nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore lidhur me anëtarët të cilët aktualisht punojnë në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Komisioni gjithashtu mori qëndrim që të kërkoj informatë me shkrim nga Këshilli Kombëtar i Shkencës lidhur me zhvillimet aktuale në Programin Kombëtar të Shkencës.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 12: 30

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Arsim Rexhepi